



Mundësi e mirë për të filluar
një perspektivë të re pune, edukimi
apo karriere në Kosovë dhe Gjermani!

Jeni duke kërkuar punë apo mundësi për zhvillim profesional në Kosovë apo Gjermani?

Ne ju ofrojmë këshillim rreth mundësive të punësimit, ofertave të aftësimit profesional dhe shërbime të nevojshme për pozicionim më të mirë në tregun vendor apo ndërkombëtar të punës.

Jeni duke menduar të migroni në Gjermani?

Ne ju ofrojmë informacion dhe këshillim rreth mundësive dhe mënyrave të migrimit legal në Gjermani, si dhe mbështetje përgjatë gjithë procesit të migrimit.

A jeni rikthyer nga Gjermania?

Ne e mbështesim riintegrimin e juaj në Kosovë dhe kontribuojmë që ky të jetë proces sa më i lehtë për ju, si nga aspekti psiko-social ashtu edhe nga aspekti profesional.

Qendra Gjermane e Informacionit për Migracion, Aftësim Profesional dhe Karrierë në Kosovë (DIMAK), në kuadër të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), ka për qëllim mbështetjen e personave që janë në kërkim të mundësive për integrim të suksesshëm në Kosovë apo Gjermani. Themeluar në vitin 2015, qendra ofron informacion, këshillim, dhe mbështetje ndaj klientëve si dhe bashkëpunon ngushtë me partnerë vendor dhe të huaj për ofrimin e shërbimeve të veçanta në fusha specifike.

Në sektorët e punësimit, aftësimit profesional dhe karrierës në Kosovë, GIZ-DIMAK bashkëpunon me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, e cila përkujdeset për këshillimin dhe orientimin e klientëve të cilët janë në kërkim të punës si dhe ofron ndërmjetësim në punësim.

Në sektorin e riintegrit, GIZ-DIMAK bashkëpunon me Ministrinë e Punëve të Brendshme – Departamentin për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar i cili ofron përkrahje ndaj të rikthyerve që nga momenti i riatdhesimit deri në riintegrimin e plotë të tyre.

SHËRBIMET E GIZ-DIMAK

... nëse kërkoni mundësi për zhvillim profesional në Kosovë, ne ju ofrojmë:

- Informacion dhe këshillim për zhvillim në karrierë: ofertat e aftësimit profesional, përzgjedhja e profesionit, perspektivat në tregun e punës
- Referim pranë ofertave të ndryshme që ofrohen nga institucionet e tjera private dhe publike
- Trajnime për hartimin e aplikacioneve për punë dhe përvetësimin e teknikave të intervistimit
- Referim tek qendrat që ofrojnë trajnime për sipërmarrësit e rinjë apo trajnime afatshkurtëra në fusha të ndryshme
- Panairë pune me punëdhënës potencial për promovimin e pozitave të hapura në treg të punës

... nëse jeni rikthyer apo dëshironi të ktheheni në Kosovë, ne ju ofrojmë:

- Këshillim sipas nevojave individuale sa jeni ende jashtë vendit apo kur të jeni kthyer në Kosovë
- Informacion rreth mundësive të punësimit apo të kualifikimit për tregun vendor
- Referim pranë programeve mbështetëse në nivel qendror dhe lokal si dhe trajnime në fushën e riintegritit social dhe profesional
- Programe mbështetëse për themelimin të biznesit dhe mentorimit
- Këshillim dhe ndërmjetësim në punësim për ekspertët e kthyer dhe ekspertët e diasporës

... nëse dëshironi të migroni, ne ju ofrojmë:

- Këshillim mbi mundësitë e zhvillimit të karrierës në Gjermani përmes vijimit të studimeve apo programeve të aftësimit profesional dhe informacion rreth bursave në dispozicion
- Informacion për punë sezonale dhe praktika profesionale në Gjermani
- Informacion rreth procedurave/kriterëve për migrim të rregullt për kategori të ndryshme si viza pune, kartoni blu apo hospitim
- Trajnim për integrim më të lehtë në Gjermani: Punësimi dhe Jetesa në Gjermani

Të gjitha shërbimet ofrohen pa pagesë!

Për informata apo konsulta mund të na vizitoni pranë qendrës sonë në Prishtinë:

DIMAK Prishtinë

Arhitekt Karl Gega, No 38
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Orari i punës:

Nga e hëna deri në të premten

8:30 – 12:00 dhe

13:00 – 16:00

Numrat Kontaktues:

Recepcioni:

+383 38 233 002 106

dimak-kosovo@giz.de

facebook.com/DIMAKKosovo

Për informata shtesë, ju lutem vizitoni:

www.startfinder.de



Duke qenë se për shkak të pandemisë së COVID-19 ndodhin edhe ndryshime të papritura, ju lutemi të verifikoni orarin e pritjes së qendrave në faqen elektronike www.startfinder.de ose të interesoheni për këtë gjë përmes telefonit. Gjithashtu duhet të keni parasysh, që për shkak të pandemisë së COVID-19 mund të ketë kufizime lidhur me shërbimet e ofruara. Ju lutemi të informoheni përmes telefonit ose me e-mail lidhur me faktin nëse shërbimet do të vazhdojnë të ofrohen normalisht apo me kufizime.

Qendra Gjermane e Informacionit për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë në Kosovë (DIMAK Kosova) është pjesë e mbështetjes për kthimin vullnetar dhe riintegrim të qëndrueshëm të ofruar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Në Kosovë drejtohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Me seli në Bonn dhe Eschborn

Projekti Global Migrimi për Zhvillim
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
66760 Eschborn, Deutschland
T +49 6196 79 - 0
F +49 6196 79 - 880
E info@giz.de
I www.giz.de

Implementuar nga:

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Në emër të



Bundesministerium für
wirtschaftliche Zusammenarbeit
und Entwicklung